L I G J
Nr.8252, datë 29.10 1997

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8222, DATË 14.5.1997 "PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 1997"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8222, datë 14.5.1997, neni 1 ndryshohet si vijon:
"Buxheti i Shtetit i vitit 1997 të jetë:
- Të ardhurat 42 525 milionë lekë
- Shpenzimet 93 395 milionë lekë"

Neni 2

Pika "a" e nenit 2 ndryshohet si vijon:
"a) Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror
- të ardhurat gjithsej 18 730 milionë lekë
* nga kontributet 10 317 milionë lekë
* transferime nga buxheti i shtetit 8 413 milionë lekë
- shpenzimet 20 160 milionë lekë"

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si vijon:
"Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore të jenë:
- të ardhurat nga fondi kundërparti 300 milionë lekë
- të ardhurat tatimore 27 775 milionë lekë
- të ardhurat jotatimore 10 450 milionë lekë
- ndihma të huaja për projekte 4 000 milionë lekë"

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si vijon:
"Kufiri maksimal i financimit të deficitit të buxhetit të përgjithshëm nga burimet e brendshme të jetë 49 000 milionë lekë.
Kufiri neto i financimit nga burimet e huaja të jetë 3 300 milionë lekë."

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si vijon:
"Shpenzimet sipas drejtimeve kryesore të jenë:
- shpenzime korrente 76 334 milionë lekë
- shpenzime kapitale 16 031 milionë lekë
- fondi rezervë i Këshillit të Ministrave 960 milionë lekë
- kontigjencë 70 milionë lekë

Kufiri i planit të shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion tjetër qendror, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, të jetë sipas pasqyrës nr.1 që i bashkëngjitet këtij ligji. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera qendrore që, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të detajojnë këtë plan në nivel artikulli, institucioni dhe në nivel nacional dhe lokal, sipas klasifikimit buxhetor, i cili miratohet nga Ministria e Financave."

Neni 6

Në nenin 9, në fjalinë e dytë, hiqen fjalët "me përjashtim të pjesës së caktuar për ruajtjen e kufirit të deficitit buxhetor prej 1 000 milionë lekësh".

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Shpenzimet kapitale nga burimet e brendshme të jenë 7 531 milionë lekë dhe nga burimet e huaja 8 500 milionë lekë".

Neni 8

Në nenin 11 të ligjit nr.8222, datë 14.5.1997 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 1997" pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Pasqyra nr.3, e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, zëvendësohet me pasqyrën me të njëjtin numër, bashkëngjitur këtij ligji."

Neni 9

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1953, datë 3.11.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.